



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – URED PREDSEDNIKA

Këshilli Organizativ për Shënimin e Dhjetëvjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës,
shpall:

KONKURS PUBLIK

**PËR DIZAJNIMIN E LOGOS, MEDALJES PRESIDENCIALE DHE PROPOZIMIN E
SLOGANIT TË 10-VJETORIT TË PAVARËSISË SË KOSOVËS**

Përshkrimi:

1. Në kuadër të përgatitjeve për shënimin e dhjetëvjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, 17 shkurt 2008 – 17 shkurt 2018, ftohen të gjithë të interesuarit, pa dallim moshe, që të bëhen pjesë e garës për dizajnimin e Logos, Medaljes Presidenciale të 10 vjetorit dhe propozimin e Sloganit të 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.
2. Kriteret që duhen marrë parasysh për Logon nuk duhet të dalin jashtë simboleve të Republikës së Kosovës, përfshirë këtu edhe ngjyrat e flamurit shtetëror.
3. Pas mbylljes së aplikimit për propozime, për dizajnimin e Logos, Medaljes Presidenciale dhe propozimin e Sloganit të 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Këshilli Organizativ për Shënimin e Dhjetëvjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës e bënë shqyrtimin e propozimeve të pranura nga shpallja publike.
4. Logo, Medalja Presidenciale dhe Slogani i 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës do të përdoret në të gjitha aktivitetet shtetërore që lidhen me shënimin e kësaj date historike
5. Personi, propozimi i të cilit zgjidhet për Logo dhe Medaljen Presidenciale të 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës shpërblehet me 1,000.00 Euro (Njëmijë).
6. Personi, propozimi i të cilit zgjidhet për Slogan të 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës shpërblehet me 500.00 Euro (Pesëqind).
7. Të drejtat e autorit, për propozimet e përzgjedhura, barten nga propozuesi tek Këshilli Organizativ për Shënimin e Dhjetëvjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Kushtet për aplikim me propozime:

Të drejtë aplikimi me propozime për Logon, Medaljen Presidenciale dhe Sloganin e 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës:

1. kanë personat fizik dhe juridik.
2. propozimet duhet të dorëzohen në letër dhe në formë elektronike.
3. propozimet për Logon dhe Medaljen Presidenciale, dhe Sloganin duhet të bëhen ndaras, mund të aplikohet për të dyja apo vetëm për njërën nga ato.

Afati dhe dorëzimi i propozimeve:

Afati i dorëzimit të propozimeve është 20 nëntor 2017.

Propozimet mund të dorëzohen në recepcionin e Ndërtesës së Kuvendit të Kosovës në Prishtinë (Sheshi Nëna Terezë p.n.), përmes postës në pliko të mbyllura apo përmes E-mail: 10vjetshtet@rks-gov.net

Propozimet dorëzohen në këtë adresë:

Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, p.n.
10 000 Prishtinë

Propozimi për Logo të 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Medaljen Presidenciale apo
Propozimi për Slogan të 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës

Nga: Emri dhe Mbiemri i autorit
Adresa dhe Kontakti

Për informata të tjera plotësuese mund të drejtoheni në:
E-mail adresën: 10vjetshtet@rks-gov.net